

BUZE DETIT, QENDRA REZIDENCIALE 6-KATESHE .



Qendra më e re rezidenciale, vetëm 50 m larg bregut të detit Jon, ngritur mbi themele të sigurta, mbart firmën e “Çobo construction”!

Një parking i gjërë nëntokësor dhe 6 kate të ngritura mbi të, i japin mundësinë kategorive të ndryshme të klientëve të për zgjedhin në të llojin e aktivitetit që do të duan të kryejnë. Ju duhet një zyrë e re? Ejani tek ne! Ju nevojitet një dyqan? Mund të zgjidhni këtu! Do të donit një restorant? E ku do të gjenit më bukur se këtu, rrethuar nga deti?!

Mendoni se mund të mos ju mjaftojë parkingu nëntokësor për gjithë automjetet tuaja?

Po, kemi menduar edhe për këtë: plotesojme nevojat tuaja me një tjetër kat parkimi, me një lartësi prej 3.80 metrash, me ndriçim natyral, që mundëson strehimin e 34 automjeteve.

Arkitektja e rezidencave luksoze



Qendra jonë rezidenciale është një kompleks ambientesh biznesi dhe banimi me një arkitekture bashkëkohore. Fasadat e xhamit, që nga kati i parë deri në të gjashtin e mbush ndërtesën me dritë. Dy katet e para, krijuar vetëm prej fasadave të xhamta, janë projektuar për të shërbyer si zyra dhe dyqane; një hyrje e përbashkët të çon drejt një hapësire gjithë dritë prej 1200 metrash katrorë prej nga një ashensor si dhe një shkallë e brendshme, të japin mundesine te eksplorosh zemrën e rezidencës. Në ngjitje, drita dhe hapësira të çelin vështrimin dhe frymëmarrjen, sepse fasadat e xhamit, si karakteristika themelore e ndërtesës ka pikërisht këtë qëllim. Harku, si elementi më tradicional i ndërtimit, ndeshet në çdo hap.

Nen ndikimin e aromes se detit, duke bërë pak hapa, tashmë për në anën jugperëndimore të ndërtesës, hyet për në katet e banuara. Në përdorim është vendosur një ashensor me kapacitet deri në 600 kg dhe shkallë paralele me një kollone ajrimi me ventilim.

Çdo shkallë ka gjashtë apartamente 3.15 metra të lartë:

- një garsonierë 44 metra katrorë;
- dy apartamente prej 100 metra katrorë ose diçka të ndërmjetme;
- tre apartamente të tjerë 60 deri 70 metra katrorë.

Ndërtesa ofron maksimumin e termoizolimit, izolimin akustik dhe hidrik. Muret përbëhen prej dy blloqe tullash 8-12 cm, të cilat ndahen në mes nga material termoizolues. Ky lloj muri siguron termoizolim dhe izolim akustik të apartamenteve. Por jo vetëm kaq. Në ndërtimin e dritareve është përdorur material plastik, i cili është shumë më rezistent sesa duralumini, që ndryshe nga ai, e ndalon kondesimin e avujve të ujit. Xhamat janë dopio dhe hapësira ndërmjet tyre është e mbushur me argon, një element izolues i përdorur ne teknologjin me te avancuar ne fushen e

ndertimit.

Muret e xhamta, që skalitin dritën.



Mermeret e bardhë mbizotërues, por edhe ata me ngjyra, reflektojnë madhështinë e qendrës rezidenciale dhe hirin e saj. Në projektimin e apartamenteve, është mbajtur parasysh veçanerisht, krijimi i kushteve maksimale për komoditetin familiar. Kështu, në funksion të komoditetit, salloni i ndenjjes është projektuar qëllimisht me pamje nga deti. Vendi i gatimit, në varësi të apartamentit, është projektuar që të krijojë mundësi amvisave të ushtrojë artin e të gatuarit të gatimit.

Në funksion të këtij komoditeti janë ndërtuar raporte të përsosura me dritën: Sallonet dhe dhomat e gjumit kanë dalje direkte në ballkon! Tualetet e bollshme me ventilim i cili realizohet neperjme dritareve dhe paisjeve specifike, sipas kërkesës së klientit. E së fundi, kurora më e bukur e rezidencës së “Çobo construction” është përshkimi i saj rreth e rreth, në tërë perimetrin, nga ballkone lineare, duke ju dhënë mundësi të shijoni aromën e detit dhe rrezet e diellit si të ishit në bregun e Jonit.

Dizenjuesi i kopshteve të gjelbra

Nuk mund të ketë ndertime cilësore që të përgjigjen kërkesave të kohës nëse nuk respektohet raporti ndërtim me ambientet e gjelberta. Një raport rëndësia e të cilit, përcaktohet nga motoja dhe praktika jonë e ndërtimit.

Ambientet tuaja të punës dhe të jetesës, rrethohen nga kopshte e lulishte të gjelbra, që përcjellin tek sytë tuaj paqen, qetësinë rregullin dhe bukurinë.